



BASHKIA
TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA TIRANË

Drejtuar: “Eurolab Internacional Grup” shpk

Adresa: Rruga Industriale Km 1, Magazine MAPO Cash & Carry, Kashar, Tiranë;

FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

* * *

Procedura e prokurimit: Me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës

Numri i referencës së procedurës: REF-55899-04-08-2020

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje paketa ushqimore dhe joushqimore për ofrimin e asistencës në banesë ndaj shtresave në nevojë”

Fondi limit: 62.491.000 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e nëntëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh.

Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: Afati për dorëzimin e mallit është brenda 1 (një) dite nga data e lidhjes së kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 10.04.2020, ora 13:00

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët X

Njoftojmë se, ka qënë pjesëmarrës në procedurë ofertuesi ekonomik me vlerën përkatëse të ofruar si më poshtë:

1. Operatori ekonomik “Eurolab Internacional Grup” shpk, NUIS K36503231E

Vlera e ofertës pa TVSH– 58.014.000 (pesëdhjetë e tetë milion e katërmëdhjetë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 69.616.800 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë

2. Operatori ekonomik “BLINISHTA” shpk, NUIS K16513001T

Vlera e ofertës pa TVSH– 62.150.000 (gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e pesëdhjetë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 74.580.000 (shtatëdhjetë e katër milion e pesëqind e tetëdhjetë mijë) lekë

3. Operatori ekonomik “NIKA” shpk, NUIS J76705047U

Vlera e ofertës pa TVSH– 61.490.000 (gjashtëdhjetë e një milion e katërqind e nëntëdhjetë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 73.788.000 (shtatëdhjetë e tre milion e shtatëqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë

4. Operatori ekonomik “SHABANI 2002” shpk, NUIS K46530201E

Vlera e ofertës pa TVSH– 62.425.000 (gjashtëdhjetë e dy milion e katërqind e njëzetë e pesë mijë) lekë

Vlera e ofertës me tvsh– 74.910.000 (shtatëdhjetë e katër milion e nëntëqind e dhjetë mijë) lekë

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

1. Operatori ekonomik “BLINISHTA” shpk, NUIS K16513001T

2. Operatori ekonomik “SHABANI 2002” shpk, NUIS K46530201E

Përkatësisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “BLINISHTA” shpk

Pas hapjes dhe shqyrtimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**BLINISHTA**” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë ligjor, teknik dhe ekonomik të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Kualifikimit dhe Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë.

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e shpall të pavlefshme këtë ofertë pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

2. Oferta e paraqitur nga operatori ekonomik “SHABANI 2002” shpk

Pas hapjes dhe shqyrtimit të ofertës, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave konstatoi se shoqëria “**SHABANI 2002**” shpk nuk ka paraqitur në sistemin elektronik dokumentacionin e plotë teknik të përcaktuara në Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, e dokumenteve standarte të tenderit për këtë procedurë, si më poshtë:

1. Nuk plotëson kriterin pika 2.2.1 e kapacitetit ekonomik dhe financiar: ku mesatarja e xhiros vjetore të viteve 2016, 2017, 2018 nuk duhet të jete më e vogël se 40% e vlerës limit të kontratës që prokurohet ose 24.996.400 (njëzetë e katër milion nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë pa tvsh. Mesatarja e xhiros së Shoqërisë “SHABANI 2002” shpk është në vlerën 22.013.434 lekë.

2. Nuk plotëson kriterin pika 2.3.1 e kapacitetit teknik: Operatori ekonomik “**SHABANI 2002**” shpk ka paraqitur fatura tatimore shitje “Ushqim i gatuar”, Katering”; ka paraqitur Kontratë furnizimi lidhur me Shoqërinë “Colombo” dhe faturat tatimore përkatëse me objekt “Furnizim me ushqime Katering (përgatitje ushqimi)”, jo në përputhje me objektin e prokurimit, duke mos plotësuar kështu kërkesën e AK për furnizime të ngjashme (mallra/ artikuj ushqimor). Procedura e prokurimit ka si objekt blerje produktesh ushqimore dhe joushqimore, pra procedurë mallrash dhe jo shërbimi.

Shoqëria “SHABANI 2002” shpk ka paraqitur Kontrata të lidhura me Spitalin Rajonal Vlorë, objekti i të cilave është në përputhje me objektin e prokurimit, por nuk ka paraqitur dokumentacionin përkatës për të të vërtetuar realizimin me sukses të këtyre kontratave (Vërtetim realizimi/ fatura tatimore të shitjes), përkatësisht për kontratat me objekt “Blerje artikuj ushqimorë për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” datë 24.5.2018, me vlerë 5.953.868 lekë pa tvsh; “Blerje ushqime për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë”, datë 23.3.2017, me vlerë 4.427.190 lekë pa tvsh, “Blerje ushqime për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” datë 9.3.2020, me vlerë 1.319.880 lekë pa tvsh.

Nga Kontratat e paraqitura në plotësim të kriterit 2.3.1, ka dorëzuar Vërtetim realizim kontrate për Kontratën me objekt “Furnizim me ushqime për vitin 2019 për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” datë 20.12.2019, me vlerë 1.323.598 lekë pa tvsh dhe “Furnizimi me ushqime për vitin 2019 për nevoja të Spitalit Rajonal Vlorë” datë 08.2.2019, me vlerë 4.015.857 lekë pa tvsh. Vlera e tyre nuk plotëson kushtin për plotësimin e kriterit të përcaktuar në DST pika 2.3.1 “Furnizime të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera/ realizuar gjatë tri viteve të fundit, ku vlera e kërkuar duhet të jetë në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet ose 24.996.400 (njëzetë e katër milion nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind) lekë pa tvsh”.

3. Nuk plotëson kriterin pika 2.3.5 e kapacitetit teknik: Operatori ekonomik “SHABANI 2002” nuk ka paraqitur për secilin nga artikujt/ produktet objekt prokurimi dëshmi të rezultateve të testeve zyrtare (të leshuara nga institucione të autorizuar dhe të akredituara të kontrollit ose referencës, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike).

Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nga shqyrtimi i kësaj oferte në mbështetje të pikës 5, të nenit 53, të Ligjit 9643, datë 20.11.2006, për “Prokurimin publik”, i ndryshuar dhe mbështetje të Kreu VII, neni 66, pika 3, të VKM nr.914, datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të prokurimit publik”, **e shpall të pavlefshme këtë ofertë** pasi nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Operatorin ekonomik “Eurolab Internacional Grup” shpk** me adresë: Rruga Industriale Km 1, Magazine MAPO Cash & Carry, Kashar, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 58.014.000 (pesëdhjetë e tetë milion e katërbëdhjetë mijë) lekë pa TVSH dhe 69.616.800 (gjashtëdhjetë e nëntë milion e gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind) lekë me TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda afatit ligjor nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të vepohet sic parashikon Ligji nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 13.04.2020.